



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

RAPORT I PROGRESIT PËR VITIN 2024
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË TURIZMIT TË KOSOVËS
2024-2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2026

Prishtinë, mars 2024

Përmbajtja

1	SHKURTESAT	3
2	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
3	PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE	6
4	PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT	6
5	RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	9
6	SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT VJETOR TË PROGRESIT PËR VITIN 2024.....	12

1 SHKURTESAT:

AICS - Italian Agency for Development Cooperations
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV- Bruto Produkti Vendor
DT - Departamenti i Turizmit
ERCA - European Ropes Course Association
FEG - European Federation of Tourist Guide Associations
GIZ - Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KIESA- Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve
MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë
MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
OZHQ - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPSE - Promoting Private Sector Employment
QK- Qeveria e Kosovës
STK - Strategjia e Turizmit të Kosovës
SKZH - Strategjia Kombëtare për Zhvillim
UNDP- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WFTGA - World Federation of Tourist Guide Associations
ZKM - Zyra e Kryeministrit

2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ka hartuar Strategjinë e Turizmit të Kosovës 2024-2026 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2024-2026, e cili është miratuar më 10 korrik të vitit 2024 në Qeverinë e Republikës së Kosovës (QRK). Strategjia është përgatitur nga Qeveria e Kosovës (QK) për të ofruar një kornizë strategjike për nxitjen e zhvillimit të turizmit në Kosovë. Hartimi i këtij dokumenti strategjik shpreh rëndësinë që Qeveria e Kosovës i kushton sektorit të turizmit në arritjen numrit të turistëve dhe ndikimit në ekonominë e Kosovës. Vizioni i Strategjisë së Turizmit është *“Deri në vitin 2030 Kosova do të shndërrohet në destinacion të qëndrueshëm turistik dhe konkurrent në Ballkanin Perëndimor”*.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ka obligim ligjor që të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Turizmit të Kosovës 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026, Prandaj ministria ka hartuar Raportin Vjetor për vitin 2024, mbi progresin e realizimit të Strategjia e Turizmit të Kosovës 2024-2026 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2024-2026, i cili është në përputhje me kërkesat e Rregullores (QRK) nr.17/2024 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në Raportin Vjetor për vitin 2024, mbi progresin e realizimit të Strategjia e Turizmit të Kosovës 2024-2030 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2024-2026 janë paraqitur aktivitetet e detajuara për zbatimin e objektivave të parashikuara në Planin e Veprimit për periudhën 2024.

Plani i Veprimit 2024-2026 i Strategjisë së Turizmit të Kosovës (STK), përfshin një listë prej pesë (5) objektivash strategjike, nëntëmbëdhjetë (19) objektivash specifike dhe njëqind e shtatëmbëdhjetë (117) aktiviteteve që parashihen të realizohen për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Raporti i progresit ka për qëllim që të evidentoj shkallën e zbatimit të projekteve të paraqitura në Plani i Veprimit 2024-2026 të Strategjisë së Turizmit të Kosovës 2024-2030 për vitin 2024, si dhe të evidentohen sfidat dhe të propozohen rekomandimet për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse.

Në raport të progresit janë përfshirë të gjitha projektet dhe aktivitetet që kanë filluar para apo gjatë vitit 2024 dhe që vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme, po ashtu edhe projektet dhe aktivitetet të cilat fillojnë dhe përfundojnë në vitin 2024. Pra, ky raport pasqyron progresin e arritur vetëm për periudhën raportuese për vitin 2024 sipas planifikimeve të paraqitura në Plani i Veprimit 2024-2026 dhe nuk paraqet rezultatet apo sfidat për sektorin si tërësi. Disa nga aktivitetet që parashihen të arrihen në vitet e ardhshme nuk janë paraqitur në këtë dokument.

Objektivat strategjike janë:

- Objektivi 1: Rritja e aktiviteteve promovuese dhe përmirësimi i rrjedhës së informacionit
- Objektivi 2: Krijimi dhe avancimi i infrastrukturës cilësore dhe të qëndrueshme për zhvillim të turizmit
- Objektivi 3: Zgjerimi i ofertës turistike sipas standardeve të qëndrueshmërisë dhe rritja e konkurueshmërisë
- Objektivi 4: Ngritja e kapaciteteve njerëzore për rritje të kuadrove në treg të punës dhe përmirësim të shërbimeve
- Objektivi 5: Avancimi i kornizës rregullative dhe të politikave të turizmit


Arritja e realizimit të objektivave për vitin 2024 ka qenë 61.14%, atyre të pa realizuara ka qenë 20.64 %, kurse aktivitetet e realizuara pjesërisht apo që janë në proces janë evidentuar rreth 18.13%

Në vazhdim janë paraqitur të arriturat e objektivave në formë tabelore dhe grafike për vitin 2024.

Tabela 1: Përqindja e realizimit, jo realizimit dhe realizimit të pjesërishtëm të objektivave për vitin 2024

Viti 2024	Realizuar	Pa realizuar	Pjesërisht
Objektivi 1	50.00%	20.00%	30.00%
Objektivi 2	61.29%	19.35%	19.35%
Objektivi 3	50.00%	41.66%	8.33%
Objektivi 4	100.00%	0.00%	0.00%
Objektivi 5	44.44%	22.22%	33.00%
Totali	61.14%	20.64%	18.13%

Grafikoni 1: Paraqitja grafike sipas përqindjes për arritjen e objektivave - viti 2024



3. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Në këtë raport të progresit është paraqitur shkalla zbatimit të aktiviteteve, dhe projekteve të parapara për vitin 2024.

Për përgatitjen e këtij raporti, është themeluar Grupi Koordinues (GK) ndërinstitucional, ku MINT, ka përgatitur matricën, dhe ju është dërguar të gjithë anëtarëve të grupit që të raportojnë për të arriturat, sfidat dhe problematikat në zbatimin e projekteve të parapara për vitin 2024. Pas marrjes së inputeve nga anëtarët e Grupit Koordinues (GK) dhe sekretariati, respektivisht Departamenti i Turizmit është bërë më tutje përpunimi i matricës dhe është bërë finalizimi.

Bazuar në të dhënat e plotësuara nga institucionet përgjegjëse në matricën e dërguar është përgatitur pjesa narrative e këtij raporti.

Në pjesën narrative është bërë përshkrimi i progresit të secilit objektivi strategjik, duke u konkretizuar edhe tek objektivat specifike, janë përshkruar të arriturat, arsyetja e vonësive të disa aktiviteteve/projekteve si dhe sfidat për disa projekte të cilat nuk janë realizuar në tërësi.

Përshkrimi i mëposhtëm është bazuar në strukturën e Planin e Veprimet për periudhën 2024-2026, për vitin 2024, ku janë të përfshira aktivitetet dhe projektet e këtij viti.

4. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT

Objektivi Strategjik 1: Rritja e aktiviteteve promovuese dhe përmirësimi i rrjedhës së informacionit

Sa i përket këtij objektivi strategjik, bazuar në treguesin 1, gjatë vitit 2024, ka pas rritje të numrit të turistëve ndërkombëtar (hyrjet në pikë kalimet kufitare) rreth 23 %, ku është arrit numri i hyrjeve ndërkombëtare në 6,906,281 nga 5,607,324 sa ka qenë në vitin bazë.

Gjithashtu avancim ka pasur edhe në arritjen e treguesit 2 të këtij objektivi gjegjësisht rritje të numrit të bujtjeve në njësi akomduese në 1,511,667, ku në vitin bazë ka qenë 567,419 apo 166 % rritje.

Objektivi Specifik 1: Promovimi i imazhit turistik të Kosovës në arenën ndërkombëtare:

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar aktivitetet për promovimin e turizmit në arenën ndërkombëtare ku është tejkalar numri i paraparë i aktiviteteve sipas treguesit 1, nga 2 aktivitetet promovuese në 5.

Sa i përket përmbushjes së objektivit specifik janë realizuar aktivitete që kanë të bëj me

prezantimin e Kosovës në platformën ndërkombëtare, duke u prezantuar në katër platforma. Poashtu progres kishte dhe në organizimin e “famtripave” dhe “presstripave” ku kishim pjesëmarrës nga Gjermania, Italia dhe Turqia.

Sa i përket pjesëmarrjes së Kosovës në panairë rajonale dhe ndërkombëtare është zgjeruar gama e këtyre aktiviteteve promovuese, dhe janë zhvilluar materiale promovuese.

Është zhvilluar brendi “Via Dinarica-Kosovo” në qarqet tashmë ekzistuese turistike në nivel rajonal dhe evropian si dhe kishte aktivitete të promovimit të brendit “Via Dinarica - Kosova”.

Objektivi specifik 2: Përdorimi i metodave digjitale në ofrimin e informacionit të turizmit dhe përmirësimi e cilësisë së informacionit turistik.

Treguesi i paraparë për këtë objektivi nuk është i matshëm për këtë periudhë, për shkak se parashihet të arrihet në periudha tjera gjithashtu dhe shumë aktivitete janë në proces.

Është zhvilluar hartëzimi digjital i Via Dinarica Kosova është finalizuar, së shpejti do të jetë i disponueshëm edhe një aplikacion për iPhone dhe Android. Ndërsa të tjerat aktivitete janë në progres e sipër.

Objektivi Specifik 3: Ngritja e bashkëpunimit në mes të akterëve të turizmit.

Në këtë objektivi ka pasur progres sipas treguesit lështë arritur numri i paraparë i aktiviteteve të bashkëpunimit me akterët kryesor.

Në lidhje me këtë objektivi është shënuar progres në organizimin e takimeve B2B në mes të operatorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë që ofrojnë ture ballkanike. Gjithashtu ka pasur progres në aktivitetet të cilat janë në proces.

Sfidat kryesore që janë vërejtur gjatë zbatimit të këtij objektivi strategjik për 2024 janë:

Në mungesë të kapaciteteve institucionale nuk kanë mundur të analizohen tregjet me potencial të gjenerimit të vizitorëve.

Sfiduese mbetet marketingu digjital i shërbimeve turistike në ofrimin e informacionit të turizmit dhe përmirësimi e cilësisë së informacionit turistik.

Sfiduese mbetet koordinimi ndër-institucional në fushën e turizmit në mungesë të formimit të Këshillit të Turizmit.

Sfiduese ka qenë edhe procesi i zhvillimit të brendit për shkak se aplikuesit nuk kanë ofruar projekt ide për t’i plotësuar kriteret. Prandaj rekomandohet që të rritet buxheti për këtë qëllim.

Nuk janë zhvilluar materialet promovuese (përfshirë spotet mediale) për turizmin e Kosovës. Nuk janë realizuar aktivitete të promovimit përmes ‘bloggerave’ dhe ‘vloggerave’ të huaj.

Të dhënat në google maps dhe maps.me për atraksionet turistike kryesore nuk janë përditësuar dhe zgjeruar gama e tyre.

Objektivi Strategjik 2: Krijimi dhe avancimi i infrastrukturës cilësore dhe të qëndrueshme për zhvillim të turizmit

Sipas treguesit 1 të këtij objektivi strategjik ka pasur progres në përmirësimin e infrastrukturës fizike në dy destinacione turistike malore.

Objektivi Specifik 1: Revitalizimi i Qendrave turistike ekzistuese

Treguesi 1 i këtij objektivi nuk është paraparë të arrihet në këtë periudhë raportuese.

Sa i përket këtij objektivi, megjithëse nuk ka pasur aktivitete të planifikuara për vitin 2024 megjithatë është realizuar një studim i fizibilitetit për një qendër turistike.

Objektivi Specifik 2: Tërheqja e investitorëve për hapjen e qendrave të reja të turizmit dimëror (skijimit).

Nuk është shënuar progres në këtë periudhë raportuese.

Nuk janë organizuar aktivitete për tërheqjen e investitorëve për këtë periudhë raportuese për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe prioritizimit.

Objektivi Specifik 3: Rritja e kapaciteteve akomoduese dhe përmirësimi i infrastrukturës së tyre.

Sipas treguesit 1 të këtij objektivi, është arritur numri i strukturave akomoduese në 530, nga 500 sa ka qenë apo rreth 6 %.

Sipas treguesit 2 ka pasur rritje në numrin e shtretërve për akomodim nga 11,000 në 19,285 apo 75 %.

Në kuadër të këtij objektivi ka pasur kryesisht kontribut disa komuna dhe organizatat donatore ku kanë ndikuar në identifikimin e kapaciteteve akomoduese dhe përmirësimin e infrastrukturës në zgjerimin e kapaciteteve.

Objektivi Specifik 4: Përmirësimi i qasjes turistike.

Sipas treguesit 1, janë kompletuar me infrastrukturë rreth 70 km rrugë dhe ky tregues ende nuk është arritur në këtë periudhë.

Bazuar në treguesin 2, gjatë vitit 2024 nëpër komuna të Kosovës janë zhvilluar më shumë se 80 km shtigje të ecjes.

Kurse sipas treguesit 3 janë zhvilluar rreth 112 km shtigje për çiklizëm nëpër komuna të ndryshme të Kosovës.

Sa i përket infrastrukturës rrugore për qasjen në zonat turistike mund të konkludohet se ka pasur ngecje, mirëpo kishte progres në zhvillimin e shtigjeve të ecjes dhe të çiklizmit dhe janë

përmirësuar ato ekzistueset.

Në lidhje me investimet në infrastrukturën e teleferikëve, ka pasur pak progres ku është zhvilluar vetëm studimi fizibilitetit për teleferikun e Kalasë së Prizrenit. Ndërsa nuk ka pasur progres në zhvillimin e transportit kabllor, ku në mungesë të buxhetit në këtë periudhë të planifikuar nuk janë zhvilluar studimet e fizibilitetit për zhvillimin e tyre.

Objektivi Specifik 5: Ngritja e infrastrukturës për mbrojtje të mjedisit.

Në vitin e parë të planit të veprimit ka pasur aktivitete kryesisht për ndërgjegjësim me qëllim të mbajtjes së mjedisit të pastër në zonat turistike. Ndërsa mbetet për tu bërë më shumë në ngritjen e infrastrukturës.

Objektivi Specifik 6: Identifikimi dhe zhvillimi i shtigjeve për turizëm të aventurës dhe skijim alpin.

Gjatë vitit 2024 ka pasur progres të theksuar në arritjen e këtij objektivi me pothuajse të gjitha aktivitetet e realizuara. Ndër aktivitetet më të rëndësishme janë 22 vija të ngjitjes, ka përfunduar zhvillimi i Via Ferrata dhe janë shenjëzuar rreth 160 km shtigje të ecjes brenda parqeve kombëtare. Kjo ka mundësuar zhvillimin e turizmit alpin dhe aventuristik ku ka pasur kontribut kryesisht nga komunitat dhe donatorët.

Objektivi Specifik 7: Menaxhimi i qëndrueshëm i atraksioneve turistike.

Janë realizuar investime infrastrukturore në disa lokacione nga trashëgimia kulturore në restaurim dhe zhvillimin e tyre për tu kthyer në shërbim të turizmit. Në këtë periudhë të planifikuar janë realizuar plotësisht aktivitetet e parapara, megjithatë shumë aktivitete mbeten për periudha të ardhshme për të arritur treguesit e paraparë në këtë objektivi.

Objektivi Specifik 8: Përmirësimi i infrastrukturës së sigurisë në destinacione turistike.

Ka pasur progres në krijimin e infrastrukturës ligjore për zhvillimin e aktiviteteve në turizmin aktiv dhe aventuristik dhe janë zhvilluar kapacitetet njerëzore për inspektimin e produkteve turistike. Shumë prej këtyre produkteve janë certifikuar sipas standardeve të ERCA-së.

Janë krijuar 3 stacione të shpëtimit malor në Pejë, Deçan dhe Junik ku janë furnizuar me pajisje të nevojshme për operacione të shpëtimit malor. Setet e pajisjeve janë në dispozicion për shpëtimtarët e trajnuar. Këto masa mund të ndikojnë në sigurinë e turistëve si dhe në zvogëlimin e rasteve të lëndimeve në destinacione malore siç është e përcaktuar në treguesin 1 të këtij objektivi.

Sfidat kryesore që janë vërejtur gjatë zbatimit të këtij objektivi strategjik për vitin 2024 janë:

Mungesa e investimeve infrastrukturore për qasjen në zonat turistike mbetet ende sfiduese.

Muzetë nuk janë kategorizuar në mungese të ligjit përkatës.

Edhe pse janë organizuar trajnime kryesisht nga donatorët ende ka nevojë për trajnimin e operatorëve në sektorin e turizmit rural dhe malor për marketing digjital.

Nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm me autoritete përkatëse për rregullimin e infrastrukturës fizike (energjisë elektrike, ujësjellësit etj.) në destinacionet turistike ekzistuese dhe në tjerat që identifikohen në ndërkohë. Prandaj kemi mungesë të investimeve në infrastrukturën fizike në destinacionet turistike.

Objektivi Strategjik 3: Zgjerimi i ofertës turistike sipas standardeve të qëndrueshmërisë dhe rritja e konkurrueshmërisë

Objektivi Specifik 1: Promovimi i zhvillimit të produkteve komerciale sipas trendëve globale.

Edhe pse aktiviteti për mbështetjen e bizneseve për artizanale nuk ka qenë i planifikuar për vitin 2024, në këtë drejtim kemi progres ku disa komuna dhe MINT kanë mbështetur bizneset artizanale përmes skemave të granteve apo subvencioneve tjera.

Objektivi Specifik 2: Përmirësimi i ofertës së kulinarisë në zona të përshtatshme për turizëm rural

Sa i përket kësaj objektivie ka pasur progres në promovimin e kulinarisë, aktivitete për ngritjen e kapaciteteve si dhe mbështetje direkte për promovimin e produkteve ushqimore tradicionale. Përkrahja bizneseve për zhvillimin e turizmit rural nga MBZHR-ja ka filluar implementimi i një projekti disa vjeçar mirëpo në vitin 2024 nuk ka arritur të realizohet thirrja për mbështetje.

Bazuar në treguesin 1, nga skemat e ndryshme mbështetëse të nivelit qendror dhe komunave kanë përfituar rreth 68 biznese turistike dhe një numër i konsiderueshëm nga organizatat donatore.

Sipas treguesit 2, numri i aktiviteteve të promovimit të ushqimeve tradicionale ka qenë 3, respektivisht janë mbajtur 3 panairë në komuna.

Objektivi Specifik 3: Zhvillimi dhe promovimi i turizmit të errët.

Sa i përket këtij objektivi ka pasur pak progres në ngritjen e kapaciteteve ku janë realizuar disa trajnime për promovimin e turizmit të errët.

Objektivi Specifik 4: Promovimi i jetës së natës dhe përfshirja e festivaleve në ofertë turistike. Për këtë objektivi janë realizuar aktivitete rreth mbështetjes së festivaleve të ndryshme me qëllim të pasurimit të ofertës turistike. Këto festivale janë të njohura ndërkombëtarisht dhe kanë sjellë vizitorë të jashtëm për të marr pjesë.

Sfidat kryesore që janë vërejtur gjatë zbatimit të këtij objektivi strategjik për vitin 2024 janë:

Mungese e subvencioneve në fushën e turizmit;

Krijimi i lidhjeve bashkëpunuese në mes të shoqatave vendore të turizmit dhe atyre të diasporës për promovimin e Kosovës si destinacion turistik;

Kalendari kulturor nuk është publikuar;

Objektivi Strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve njerëzore për rritje të kuadrove në treg të punës dhe përmirësim të shërbimeve

Sipas treguesit 1 të këtij objektivi strategjik, numri i të punësuarve në sektorin e turizmit ka pasur rritje nga 21,862 në 31,664 apo rreth 45%.

Objektivi Specifik 1: Nuk ka aktivitete të planifikuara për vitin 2024.

Objektivi Specifik 2: Krijimi i programeve për arsim dhe aftësim profesional të dedikuara për sektorin e turizmit.

Sa i përket këtij objektivi nga MASHTI janë trajnuar mësime dhënësit dhe instruktoret e përfshirë në fushën e turizmit, gjithashtu edhe 6 trajner janë trajnuar nga FEGO në fushën e udhërrëfyesve.

Sfidat kryesore që janë vërejtur gjatë zbatimit të këtij objektivi strategjik për vitin 2024 janë:

Zhvillimi i kuadrove profesionale të gatshme për tregun e punës sipas kërkesave në sektorin e turizmit;

Harmonizimi i kurrikulave me nevojat e tregut të punës.

Objektivi Strategjik 5: Avancimi i kornizës rregullative dhe të politikave të turizmit

Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe i politikave turistike me fokus në qëndrueshmëri

Sa i përket këtij objektivi ka pasur avancim lidhje me hartimin e infrastrukturës ligjore ku janë rregulluar disa fusha prej tyre disa për herë të parë në Kosovë, kurse sa i përket aktivitetit për krijimin e lehtësirave për ardhjen e vizitoreve nuk ka ndodhur ndonjë lehtësim për regjimin e vizave.

Bazuar në indikatorin 1, gjatë vitit 2024 janë përgatitur draftet e U.A të parapara me Ligjin e Turizmit dhe janë miratuar 4 prej tyre.

Objektivi Specifik 2: Krijimi i një infrastrukture të standardizuar për mbledhje dhe prezantim të të dhënave në fushën e turizmit

Për këtë objektivi ka pasur progres në identifikimin e indikatorëve të nevojshëm për statistikat e turizmit në harmoni me Eurostatin.

Sipas treguesit 2, kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe është zhvilluar Softueri për regjistrin e turizmit.

Sfidat kryesore që janë vërejtur gjatë zbatimit të këtij objekti strategjik për vitin 2024 janë:

Edhe pse ka pasur avancim në krijimin e infrastrukturës ligjore megjithatë ende shumë rregullore nuk janë miratuar;

Megjithëse ka pasur avancim sa i takon përmirësimit të statistikave, por sfidë mbetet matja e saktë e ndikimit të turizmit në ekonominë e vendit.

5. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Gjatë monitorimit të zbatimit të Strategjisë së Turizmit të Kosovës (STK) për periudhën 2024, kemi hasur në disa rreziqe të cilat lidhen me kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm që janë shfaqur gjatë realizimit të aktiviteteve, dhe që ndikojnë në zbatimin e dokumentit strategjik.

Në kuadër të monitorimit të Zbatimit të Strategjisë së Turizmit të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë (MINT), përkatësisht Departamenti i Turizmit ka koordinuar procesin e hartimit të Raportit të Progresit aktiviteteve të parapara. Ky monitorim është bërë duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse ku janë identifikuar rreziqet të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. MINT do të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit të turizmit në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Konstatimi i ngecjeve në realizimin e disa projekteve të parapara na drejton në marrjen e hapave të domosdoshëm, dhe konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit.

Sfidat dhe mangësitë kryesore:

Sektori i turizmit në Kosovë ka hasur në shumë sfida që lidhen kryesisht me mungesën e kapaciteteve institucionale dhe mungesën e një koordinimi efektiv ndër-institucional. Kjo ka penguar analizimin e tregjeve me potencial për tërheqjen e vizitorëve, duke penguar mundësinë për zhvillimin e aktiviteteve të marketingut dhe promovimit, sidomos marketingu digjital i shërbimeve turistike mbetet një sfidë, pasi informacioni turistik është i pamjaftueshëm dhe cilësia e tij duhet përmirësuar.

Mungesa e Këshillit të Turizmit, që do të mundësonte një koordinim më të mirë mes institucioneve përgjegjëse. Brendimi ka ngecur për shkak të mungesës së projekteve cilësore dhe fondeve të mjaftueshme. Gjithashtu, nuk janë zhvilluar mjaftueshëm materiale promovuese për turizmin e Kosovës.

Një tjetër problem është përditësimi i të dhënave për atraksionet turistike në platformat si Google

Maps dhe Maps.me, që ende nuk janë zgjeruar apo përmirësuar. Po ashtu, infrastruktura për qasjen në zonat turistike është e papërshtatshme, dhe investimet në këtë fushë mbeten të pamjaftueshme. Mungon gjithashtu një bashkëpunim i mjaftueshëm me autoritetet përkatëse për rregullimin e infrastrukturës fizike, si energjia elektrike dhe ujësjellësit, në destinacionet turistike ekzistuese dhe ato të mundshme në të ardhmen. Kjo ka shkaktuar një mungesë investimesh në infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e turizmit.

Pavarësisht organizimit të trajnimeve nga donatorë, ka ende nevojë për trajnime shtesë për operatorët turistik. Përveç kësaj, mungojnë subvencionet në sektorin e turizmit, dhe krijimi i lidhjeve bashkëpunuese mes shoqatave vendore të turizmit dhe atyre të diasporës për promovimin e Kosovës si destinacion turistik ka ngecur.

Edhe pse ka pasur disa përparime në krijimin e një infrastrukture ligjore, shumë rregullore të nevojshme ende nuk janë miratuar. Ndërkohë, nëpërmjet përmirësimit të statistikave, mbetet ende sfida matja e ndikimit të turizmit në ekonomi.

Këto probleme kërkojnë një angazhim të fortë nga autoritetet dhe palët përkatëse për të krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e turizmit në Kosovë.

Konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm

Gjatë monitorimit të Raportit të Progresit, mund të konstatohet se është shënuar një progres i kënaqshëm, respektivisht në vitin 2024 është arritur realizmi i objektivave në një masë rreth gjashtëdhjetë e një përqind (61%), kurse pjesa tjetër nuk ka mundur të realizohet ose është realizuar pjesërisht.

Një ndër arsyet e pengesave të realizimit të aktiviteteve janë: mungesa kapaciteteve të institucioneve të mjaftueshme për zhvillim dhe promovim e turizmit, mungesa e mjeteve financiare, mungesa e koordinimit ndërinstitucional.

Rekomandimet:

Për hapat e ardhshëm duke u bazuar në konkluzionet dhe të gjeturat nga raportimi i institucioneve mbi zbatimin e aktiviteteve dhe masave në kuadër të objektivave strategjike janë:

- Bashkëpunimi më i mirë mes nivelit qendror dhe lokal;
- Bashkëpunimi me OJQ-të relevante për promovim të turizmit;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale në veçanti për zhvillimin dhe promovimin e turizmit;

- Planifikimi i duhur i buxhetit në raport me planifikimin e projekteve;
- Prioritizim për promovimin e turizmit në veçanti promovimit dhe marketingut digjital;
- Këshillit i Turizmit të themelohet dhe funksionalizohet për shkak se ka rëndësi vitale për koordinim ndërinstytucional si dhe prioritizim të sektorit;
- Të përditësohen të dhënat në platforma digjitale kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të përgatitet kalendari i ngjarjeve ndërkombëtare të organizuara për turizëm;
- Të koordinohen aktivitetet me institucionet e sigurisë duke i përfshirë edhe forumet lokale të sigurisë
- Të rritet buxheti për projektet infrastrukturore për qasjen në destinacione turistike;
- Të definohet statusi i qendrave turistike ekzistuese si dhe të investohet në këto qendra;
- Të kompletohet infrastruktura ligjore, në veçanti ajo për muzetë;
- Të organizohen trajnime për operatorët në sektorin e turizmit për fusha specifike;
- Të zhvillohen skema dhe përkrahen bizneset që operojnë në fushën e turizmit;
- Të organizohen ngjarje me fokus të veçantë investimeve në fushën e turizmit;
- Të përmirësohet tutje korniza e statistikave për turizëm, grumbullimi i statistikave:
 - Të shtohen statistikave për Airbnb;
 - Të shikohen mundësitë e formalizimit të akomodimit, për qëllim të turizmit.

6. SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2024

Kjo shtojcë reflekton formatin e planit të veprimit me aktivitete që kanë qenë të planifikuara vetëm për vitin 2024.

Raportimi vjetor i zbatimit sipas Planit të Veprimit 2024-2026 për aktivitetet e vitit 2024

Nr.	Veprimi	Vlera bazë 2021	Synimi i përkohshëm 2026	Synimi i vitit të fundit 2030	Rezultati
Objektivi Strategjik I : Rritja e aktiviteteve promovuese dhe përmirësimi i rrjedhës së informacionit					
	Treguesi 1: Rritja e numrit të turistëve ndërkombëtar (hyrjet në pikë kalimet kufitare)	5 ,607, 324	30% (7,289,521, 2)	50% (8,410,986)	
	Treguesi 2: Numri i bujtjeve të realizuara në njësi akomoduese	567.419	700,000	900,000	
Objektivi Specifik 1 : Promovimi i imazhit turistik të Kosovës në arenën ndërkombëtare					

	Treguesi 1: Numri i aktiviteteve të promovimit turistik të Kosovës në arenën ndërkombëtare	2	5	10					
Nr.	Veprimi	2024	2025	2026	Burimet e financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Statusi i progresit	Sqarim i shkurtër i progresit
1.1.1	Brendimi i Kosovës si destinacion turistik	10,000.00	50,000.00	50,000.00	Buxheti i Kosovës	MINT	Brendi i turizmit të Kosovës (logoja, slogani dhe përgjithësi sht identiteti) i zhvilluar	Pjesërisht	Gjatë vitit 2024 Departamenti i Turizmit ka hartuar termat e referencës për publikimin e shpalljes publike për dizajnimin e simbolit shtetëror për brendimin e turizmit të Kosovës. Gjithashtu është përgatitur edhe një video informuese për procedurat e aplikimit dhe informimin e qytetarëve për të aplikuar mirëpo nuk janë shpallë.

1.1.2	Vendosja e Kosovës në platforma ndërkombëtare të promovimit të turizmit	30,000	30,000	30,000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MINT/ KIESA/ PPSE	Kosova e prezantuar se paku në dy platforma ndërkombëtare	Realizuar	Duke qenë se MINT ka marrëveshje bashkëpunimi me organizatat/shoqatat e më poshtme Kosova është disa platforma ndërkombëtare. PPSE - Artikuj promovues publikuar në 'The Guardian', 'Backline', 'Sueddeutsche Zeitung' UTK Me përkrahje nga MPJ është promovuar Kosova përmes UTK në gazetën Focus City On Today dhe Daily Obserever GUIDEKS - duke qenë anëtare e asociuar e FEG ose (European Federation of Tourist Guide Associations). https://www.feg-touristguides.com , promovohet Kosova në platformën dhe rrjetet sociale të kësaj organizate https://www.fegtouristguides.com/guides.php Gjithashtu, Kosova promovohet si destinacion turistik përmes GUIDEKS edhe në WFTGA (World Federation of Tourist Guide Associations). https://wftga.org/members/full-members/#!biz/id/6426d5748b0db911f33acb72 https://www.facebook.com/share/p/1C8tSr4B4s/?mibextid=qi2Omg
1.1.3	Hulumtimi i tregjeve me potencial të gjenerimit të vizitorëve	10,000	20,000	20,000	Buxheti i Kosovës	MINT	Raporti mbi tregjet potenciale të vizitorëve i përfunduar	Realizuar	Gjatë vitit 2024 nuk është ndërmarrë ndonjë veprim

1.1.4	Zhvillimi materialeve promovues e për turizmin në Kosovë	5,000	5,000	5,000	Buxheti i Kosovës	MINT/KIESA	Materialet promovues e (përfshirë spotet mediale) për turizmin e Kosovës të prodhuara	Pjesërisht /në proces	Video për promovimin e turizmit dimëror në Gjeravicë (freeride, ecje me dëborë dhe ski touring), realizuar nga KIESA & PPSE
1.1.5	Promovimi i Kosovës përmes 'bloggerave' dhe 'vlogerave' të huaj	5,000	15,000	15,000	Buxheti i Kosovës,	MINT/KIESA/Ambasada Italiane	Sponsorizimi i së paku 1 'blogger' ose 'vloger' në vit	Pa realizuar	Në mungesë të kapaciteteve ende nuk ka mundur të realizohet ky aktivitet.
1.1.6	Organizimi i "famtripave" dhe "presstripave"	20,000	20,000	20,000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MINT/KIESA/PPSE	Të paktën një "famtrip" ose "presstrip" i realizuar në vit	Realizuar	Një Fam Trip me Tour Operatore Gjermano-folës dhe media është realizuar në vitin 2024. Janë publikuar artikuj promovues në 'The Guardian', 'Backline', 'Sueddeutsche Zeitung' . Gjithashtu është realizuar një Fam Trip me pjesëmarrjen e rreth 12 bizneseve turistike nga Turqia me përkrahje nga zyra e Kryeministrit dhe zbatuar përmes UTK. Në at Fam Trip ka marr pjesë një medium turk.

1.1.7	Pjesëmarrja e Kosovës në panairë rajonale dhe ndërkombëtare	50,000	100,000	100,000	Buxheti i Kosovës, Donatorët	MINT/KIESA/PPSE	Pjesëmarrja së paku në 4 panairë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar	Realizuar	<p>Kosova është promovuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - panairin ITB -Berlin, ku kanë marrë pjesë 6 tour operatorë, është realizuar nga KIESA - panairin Travel News Market -në Stockholm, Suedi ku kanë marrë pjesë 5 tour operatorë, është realizuar nga KIESA dhe PPSE (projekti FEGO, Swisscontact); - panairin Global Albanian Gastronomy Festival 2024, Berlin, Gjermani, ku kanë marrë pjesë disa kompani/komuna kosovare, organizuar nga KIESA - panairin Emit në Stamboll, ku kanë marrë pjesë 12 biznese turistike me përkrahje nga PPSE, organizuar nga UTK - panairin Expocity, Shqipëri, me pjesëmarrjen e 8 bizneseve me përkrahje nga PPSE, organizuar nga UTK <p>Panairi ndërkombëtar i turizmit Kosova 2024, Prishtinë, ku kanë marrë pjesë 300 biznese nga fusha e turizmit nga 14 shtete, i organizuar nga UTK</p>
1.1.10	Përfshirja e brendit “Via Dinarica-Kosovo” në qarqet tashmë ekzistuese turistike në nivel rajonal dhe evropian.	5,000	32,400	-	Donatorët	AICS/AMB ASADA ITALIANE	Regjistrimi i brendit Via Dinarica Kosova; 2 udhëtime në blog, 1 EduTour; pjesëmarrje në 6 aktivitete sektoriale në Itali	Realizuar	<p>Brendi i Via Dinarica Kosova është regjistruar në API si marke e mbrojtur nga projekti NaturKosovo dhe në bashkëpunim me MINT/Departamentin i Turizmit dhe komunat përkatëse.</p>

1.1.1 1	Realizimi i një fushate mbi brendin, e fokusuar në brendin turistik "Via Dinarica - Kosova"	9,000	18,000	-	Donatorët	AICS/AMB ASADA ITALIANE	Krijimi i një brendi dhe prodhimi i materialit informativ-promocional; krijimi i një faqe interneti dhe media sociale kushtuar brendit "Via Dinarica Kosovo"; promovimi i brendit në mediat tradicional e dhe online	Realizuar	Brendi i Via Dinarica Kosovo është krijuar dhe promovuar në media sociale si dhe është zhvilluar webfaqja Via Dinarica Kosovo përmes NaturKosovo dhe në bashkëpunim me MINT/Departamentin i Turizmit dhe komunat përkatëse.
------------	---	-------	--------	---	-----------	-------------------------------	--	-----------	---

Objektivi Specifik 2 : Përdorimi i metodave digjitale në ofrimin e informacionit të turizmit dhe përmirësimi e cilësisë së informacionit turistik

	Treguesi 1: Atraksionet turistike të digjitalizuara	0	100 të reja	300 të reja					
Nr.	Veprimi	2024	2025	2026	Burimet e financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Statusi i progresit	Sqarim i shkurtër i progresit

1.2.2	Organizimi i punëtorive për përditësimin e të dhënave mbi trashëgimitet e vendit në platformat e hapura në internet (p.sh. Wikipedia)	30,000	30,000	30,000	Buxheti i Kosovës	MINT, MKRS	Një punëtor në vit për përditësimin e të dhënave mbi trashëgimitet e vendit në platformat e hapura në internet	Pa realizuar	Nuk është mbajtur asnjë punëtor
1.2.4	Vendosja e atraksioneve turistike në harta digjitale (google maps, maps.me dhe të ngjashme)	3,000	5,000	-	Donatorët PPSE	MINT	Atraksionet turistike kryesore të vendosura në google maps dhe maps.me	Pjesërisht	Atraksionet turistike kryesore janë të vendosura në google maps dhe maps.me. Ky aktivitet është realizuar nga PPSE. Ky aktivitet vazhdon për të përfshirë edhe atraksione tjera.
1.2.5	Optimizimi i makinave të kërkimit ("search optimization engine") për sajtet me interes për promovim të turizmit.	12,000	12,000	12,000	Donatorët	MINT, Donatorët	Numri i vizitave	Pa realizuar	Gjatë vitit 2024 nuk është ndërmarrë asnjë veprim

1.2.6	Krijimi i një liste të kontakteve me akter mediatik ndërkombëtar	300	500	500	Buxheti i Kosovës	MINT/KIES A	Lista e kontakteve me akter mediatik ndërkombëtarë	Realizuar	Lista e kontakteve me akter mediatik ndërkombëtarë e realizuar
1.2.9	Vendosja e tabelave informuese në monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me përmbajtje dhe me QR kod të integruar	120,000	120,000	120,000	Buxheti i Kosovës	MINT, MKRS, MMPHI, Instituti i Historisë, Instituti për Mbrojtjen e natyrës	Së paku 60 atraksione të pajisura me tabela informuese	Pjesërisht	Nga MMPHI deri me tani janë shenjëzuar dhe vendosur rreth 200 tabela informuese për vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës. Tabelave të vendosura në vlerat e trashëgimisë natyrore ju mungon (nuk kanë të integruar) QR kod. Nga MKRS nuk ka pasur ndonjë progres, pasi që tenderi i shpallur ka dështuar për arsye se projekti ka pasur nevojë për revidim, kurse Kompania që e ka hartuar projektin nuk është përgjigjur dhe kemi ngecje në procedura.
1.2.10	Realizimi i një trajnimi mbi marketingun digjital për ofruesit e shërbimeve në lidhje me turizmin rural dhe malor	5,000	5,000	5,000	Buxheti i Kosovës Donatorët	AICS/AMB ASADA ITALIANE	40 operatorë në sektorin e turizmit rural dhe malor janë trajnuar për marketing digjital	Pjesërisht	Trajnimi është zbatuar nga projekti Natur Kosovo në komunat Pejë, Deçan dhe Junik ku janë trajnuar disa tour operator.
1.2.11	Hartëzimi i shtigjeve natyraliste të Via Dinarica	28,000	24,500	10,500	Donatorët	AICS/AMB ASADA ITALIANE	Krijimi i kadastrës digjitale të shtigjeve të Via	Realizuar	Hartëzimi i Via Dinarica Kosova është finalizuar. Së shpejti do të jetë i disponueshëm edhe një aplikacion për iPhone dhe Android.

